



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Kaçanik
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

01Nr.350/02-16992/22
Kaçanik, 27.06.2022

Në bazë të nenit 12.1 dhe nenit 82.3 të Ligjit 03/L-040 –Për Vetëqeverisje Lokale(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/ 04 Qershor 2008), nenit 53 të Ligjit Nr. 05/L- 031- për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 19/ 16 Qershor 2016), të nenit 34.5 të Statutit të Komunës së Kaçanikut, duke vepruar sipas Kërkesës së MBPZHR 1882//2 të datës 14.06.2022, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me 27 Qershor 2022, mori këtë:

VENDIM

PËR ANULIMIN E VENDIMIT TË KK 01NR.06-350/01-2433/22 I DATËS 29.04.2022 – PËR NDËRRIMIN E DESTINIMIT TË TOKËS BUJQËSORE NË TOKË NDËRTIMORE NË SIP. 1001m² NË PK 01123-6 ZK KAÇANIK I VJETËR, ME KULTURË BUJQËSORE ARË E KLASËS 6 PRONË E KBI

1. Me këtë vendim, **ANULOHE**T Vendimi i Kuvendit të Komunës 01Nr.06-350/01-2433/22 i datës 29.04.2022 – për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore në sipërfaqe 1001m² në Parcelën Kadastrale Nr. P- 01123-6 Zona Kadastrale Kaçanik i Vjetër, në ÇARDAK, me kulturë bujqësore Arë e klasës 6, pronë e Këshillit të Bashkësisë Islame (KBI) Kaçanik.
2. Anulimi i Vendimit i përcaktuar si në pikën 1 të këtij Vendimi, bëhet sipas Kërkesë të MBPZHR Nr. 1882/2 të datës 14.06.2022, për shkak se i njëjti është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.
3. Vendimit i bashkëngjiten: Shkresa e MBPZHR Nr.1882/2; Vendimi 01Nr. 06-350/01-2433/22; Fleta poseduese; kopja e planit.
4. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës -MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.
5. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtje të Mjedisit. .

Me këtë Vendim njoftohen: MAPL, Kryetari i Komunës; Drejtoria e Urbanizimit Kadastrit dhe Mbrojtje të Mjedisit (përmes kësaj drejtorie njoftohet pala dhe mekanizmat tjerë relevantë), Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



1	20.06.2022	Ven	KAÇANIK
ij. org.	Numri	Shtojcë	
	01-350/02-16992/22		

Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Departamenti Ligjor/Pravni Departament/ Legal Department

Për:	Besim Ilazi, Kryetari i Komunës së Kaçanikut Kemajl Murseli, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut	
Kopje:	Venera Çerkini, Zv. Sekretare e Përgjithshme, MAPL Besim Myrtezani, Zv. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave Gëzim Sahiti, Zyrtar i Lartë për Monitorim të Komunave	
Përmes:	Faton Peci, Ministër i MBPZHR-së Blerim Hasani, Sekretari i Përgjithshëm i MBPZHR-së	
Nga:	Isah Rudaku, Zv. Drejtor i Departamentit Ligjor, MBPZHR	Datë: 25.05.2022 Ref.10.103/2022
Zyrtarët përgjegjës: 1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor 2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Isah Rudaku, Zv. Drejtor i Departamentit Ligjor, MBPZHR	
Lënda:	Përgjigje në Kërkesë për rishqyrtimin e ligjshmërisë së aktit të Komunës së Kaçanikut	
Lloji i aktit:	Vendimi 01Nr.06-350/01-2433/22 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore	

I/e nderuar Kryetar,
I/e nderuar Kryesues,

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, më datë 13.05.2022, ka pranuar nga MAPL, Vendimin 01Nr.06-350/01-2433/22 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Kaçanikut, dhe i nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut me datën 29.04.2022 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në ndërtimore si dhe i parashtruar për shqyrtim në MAPL, me datën 10.05.2022.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, pas shqyrtimit të ligjshmërisë ashtu siç parashihet në nenin 81 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe në pajtim me Nenin 4 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, bënë:

Rishqyrtimin e Ligjshmërisë së Aktit

Vendimi 01Nr.06-350/01-2433/22 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Kaçanikut, dhe i nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut me datën 29.04.2022.

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 10.05.2022

Vendimi 01Nr.06-350/01-2433/22 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Kaçanikut, dhe i nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut me datën 29.04.2022 për PK 01123-6 Kaçanik i Vjetër, me kulturë bujqësore Arë e klasës gjashtë (6), me sipërfaqe 1001m² pronë e Këshillit të Bashkësisë Islame (KBI) është në kundërshtim me Nenin 11 paragrafi 11.2 dhe paragrafi 11.4 si dhe nenit 44 paragrafi 44.1. të Ligjit Nr.02/L-26 për Tokën Bujqësore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.13/01.06.2007),, *citohet*:

Neni 11. Paragrafi 11.2. *“Ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore mund të bëhet vetëm në pajtim me planin e rregullimit hapësinor dhe dispozitat tjera të përcaktuara me Ligj”.*

Neni 11 paragrafi 11.4. *“Tokës bujqësore nga neni 10.5 (a) dhe (b) nuk mund t’i ndërrohet destinimi dhe ajo nuk mund të filloj të përdoret për qëllime jobujqësore, nëse për atë rajon nuk është nxjerr plani hapësinorë, përkatësisht plani zhvillimor komunal me të cilin kësaj toke i është përcaktuar destinimi tjetër”.*

Neni 44 paragrafi 44.1. *“Deri në nxjerrjen e planit hapësinor shfrytëzimi i tokës bujqësore për qëllime jobujqësore mund të bëhet vetëm në bazë të vendimit të kuvendit komunal”.*

Arsye tjetër e anulimit të vendimit të lartpërmendur është se Komuna e Kaçanikut e ka të aprovuar Planin Zhvillimor Komunal me datën 28 Dhjetor 2010. Kjo parcele gjendet brenda Planit Zhvillimor Komunal dhe është e përcaktuar si toka bujqësore (në Listë distribuimi të DUKMM) e nuk është e përcaktuar si tokë për ndërtim. Vendimi i aprovuar nga Kuvendi i Komunës së Kaçanikut i datës 29.04.2022 është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi sepse *“me planin zhvillimor komunal nuk është paraparë si tokë ndërtimore por është tokë bujqësore”* i cili Plan që buron nga Ligji Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor të Kosovës - është e planifikuar si tokë bujqësore, në të cilën nuk lejohet ndërtimi, pra gjendet jashtë zonës ndërtimore, dhe rrjedhimisht nuk lejohet as ndërrimi i destinimit nga tokë bujqësore në tokë ndërtimore.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës **është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.**

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, mbetet në dispozicion të MAPL dhe komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.

Me respekt,



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 06-350/01-2433/22
Kaçanik, 29.04.2022

Në bazë nenit 11 dhe 12 lidhur me nenin 17 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare Nr. 28/4 Qershor 2008), të nenit 10.5 të Ligjit nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore (Gazeta Zyrtare Nr. 13/01 Qershor 2007), të nenit 3 lidhur me nenin, 6 pika 3 e Udhëzimit Administrativ Nr. 41/2006 për Ndërrimin e Destinimit të Tokës Bujqësore, të Propozim Vendimit të Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit 06 Nr. 350/01-2433/2022 (bashkëngjitur), Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e vet të mbajtur më datë 29 Prill 2022, mori këtë:

V E N D I M

PËR NDËRRIMIN E DESTINIMIT TË TOKËS BUJQËSORE NË TOKË NDËRTIMORE, NË SIP. 1001m² PK 01123-6 ZK KAÇANIK I VJETËR, ME KULTURË BUJQËSORE ARË E KLASËS 6, PRONË E KBI

1. Me këtë Vendim, MIRATOHET Propozim Vendimi i Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit 06 Nr. 350/01-2433/22- Për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, në sipërfaqe **1001m²** në Parcelën Kadastrale Nr. **P-01123-6** Zona Kadastrale Kaçanik i Vjetër në ÇARDAK, me kulturë Bujqësore Arë e Klasës së 6, pronë e Këshillit Bashkësisë Islame (KBI) Kaçanik.
 2. Sipas Planit Zhvillimor Komunal, Parcela **01123-6**, Zona Kadastrale Kaçanik i Vjetër është me destinim Tokë Bujqësore (theksuar në listë distribuimi të DUKMM).
 3. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi janë: Propozim Vendimi i DUKMM; Procesverbali i komisionit; Listë distribuimi i DUKMM, Certifikata e pronës; Kopja e planit dhe koordinatat e objektit që planifikohet të ndërtohet, Kërkesa e palës, Pëlqimi i DUKMM.
 4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës- MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.
 5. Zbatimi i këtij vendimi bëhet pas pagesës së taksave për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në atë ndërtimore të përcaktuara sipas Rregullores për taksat komunale.
 6. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesën: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit si dhe Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari.
- Me këtë Vendim njoftohen:** Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit (përmes kësaj drejtorie njoftohet pala dhe mekanizmat tjerë relevant), Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Skupština Opština
Municipal Assembly
06-350/01-2433/22

15.04.2022

Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit e Komunës e Kaçanikut duke u bazuar në nenin 10.5 pika a të Ligjit Nr.02/L-26, për Tokën Bujqësore; në bazë të nenit 6 pika 6.3 të Udhëzimit Administrativ Nr.41/2006, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, lidhur me kërkesën 06-350/01-2433/22 për ndërrim destinimi të tokës bujqësore:

Propozim

Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendin Komunal, që lidhur me kërkesën nga Këshilli i Bashkësisë Islame nga Kaçaniku për ndërrim destinimi të tokës nga ajo bujqësore në atë ndërtimore, të merr këtë:

VENDIM

Aprovohet kërkesa 06-350/01-2433/22 e datës 25.01.2022 e parashtruar nga KBI për lejimin e ndërrimit të tokës bujqësore në atë ndërtimore 1001m², në parcelën kadastrale nr.P-01123-6, zona kadastrale Kaçanik i Vjeter, me kulturë Bujqësore Arë e Klasës 6, me sipërfaqe 600m², pronë e KBI.

Arsyetim

Në drejtorinë e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit ka arritur kërkesa me numër 06-350/02-10174/22 për ndërrimin e destinimit nga toka me kulturë Tokë Bujqësore-Arë e Klasës 6 në tokë ndërtimore.

Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për ndërrim destinim ka rekomanduar DUKMM për lejimin e ndërrimit të destinimit.

Drejtore i DUKMM-së

Qamil Stagova





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Kaçanik
Opština Kaçanik
Municipality Kaçanik

Komisioni për ndrrim destinimi të tokës bujqësore

DATE:	15.04.2022
REFERENCE:	06Nr.350/02-2433/22
PËR:	Drejtorinë e DUKMM-së
CC:	
PËRMES:	
NGA:	Komisioni: 1. Mustafë Loku 2. Rakip Vishi 3. Ardite Shehu
TEMA:	Proqesverbal lidhur ndrrimin e destinimit të tokës bujqësore në ng. 01123-6

I përpiluar më datën 15.04.2022 lidhur me kërkesën Nr. 06Nr.350/02-2433/22 të datës 15.04.2022 të parashtruar këtij komisioni nga Drejtoria e DUKMM-së, lidhur me kërkesën e paraqitur kësaj Drejtorie nga **KBI Kaçanik**, për ndërrim destinimi të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.

Lidhur me kërkesën komisioni ka dalur në vendin e ngjarjes dhe ka konstatuar siç vijon:

Bazuar sipas çerifikatës me nr. të lëndës **2427/2022**, Zona kadastrale Kaçanik i Vjetër, ngastra nr. P-70917086-01123-6, me kulturë arë e Kl 6. me sipërfaqe prej 1001m² pronësi individuale, evidentuar në emër të Këshillit të Bashkësisë Islame Kaçanik.

Parcela në fjalë gjindet në Kaçanik, lagjja Çardak, Kaçanik i Vjetër sipas gjendjes faktike livadh, zonë urbane, ku në të gjitha anët është e rrethuar me shtëpi banimi

Komisioni rekomandon DUKMM që në parcelën e lartëcekur të lejohet ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore në sipërfaqe prej 1001 m², pasi që parcela në fjalë me kohë ka humbur karakterin bujqësor, ku në të gjitha anët është e rrethuar me shtëpi banimi dhe është në interes të përgjithshëm shoqëror.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Kaçanik
Opština Kaçanik
Municipal of Kaçanik

Departamenti i Urbanizimit, Kadastrit
dhe Mbrojtjes së Mjedisit
06- 350/02-2433/22

LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP

REFERENCE:					
PËR/ZA/TO:	Mustafë Loku, Arditë Shehu, Ragip Vishi				
CC:					
PËRMES/PREKO/THROUGH:					
NGA/OD/FROM:	Qamil Stagova, drejtor i DUKMM-së				
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Ndërrim destinimi-KBI				
Nr. i zyrës:		Lokacioni:		Data:	
Br. kancelarije:		Kucni:	Administrata Komunale	Datum:	
Room No.:		Extension:		Date:	15.04.2022
PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOST/FOR ACTION					X ☐
PËR MIRATIM/ZA USVAJANJE/FOR APPROVAL					☐
PËR INFORMIMIN TUAJ/ZA VASU INFORMACIJU/FOR YOUR INFORMATION					☐
AFATI/KRAJNI ROK/DEADLINE					

Me anë të kësaj shkrese njoftoj komisionin me kërkesën e KBI për ndërrimin e destinimit.

Sipas Planit Zhvillimor Komunal parcela 01123-6, zona kadastrale Kaçanik i Vjetër është e paraparë Tokë Bujqësore.

Të bashkangjitur keni kërkesën për ndërrim destinim, fletën poseduese, kopjen e planit dhe koordinatat e objektit që planifikohet t ë ndërtohet.

Me respekt



Republika e Kosovës
Republika Kosovo–Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70917086-01123-6

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: 2427/2022
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: 25.01.2022 - 09:51
Komuna / Opština / Municipality: KAÇANIK / KAÇANIK / KAÇANIK
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Kaçanik I Vjetër / Stari Kaçanik / Kaçaniku I Vjetër
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: KAÇANIK / KAÇANIK / KAÇANIK

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësise kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësise Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m ²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-70917086-01123-6	PARCELE / PARCELA / PARCEL	Pronë private / Privatna Imovina / Privately owned Land	Rural	1001	12-1986	12.08.2021	12.08.2021

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendbanimi - adresa Prebivalište - adresa Resident - address	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Hollësitë e adresës Pojednosti adrese Address Details	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
ÇARDAK/ÇARDAK/ÇARDAK			12.08.2021	12.08.2021



A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja (m²) Površina (m²)
1	Bujqësore/Poljoprivredno/Agriculture	Arau/Njive/Arable	Arë E Klasës 6/Njiva 6 Klase/6th Class Arable Land	1001

B. PRONAR/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi posttal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednosti adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhurnuar Azurirano Updated
Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	Këshilli i Bashkësisë Islame Kacanik Bashkësia Islame e Republikës së Kosovës dhe Këshilli i Bashkësisë Islame	601681572	KACANIK / KACANIK / KACANIK /		E.DURAKU	1/1	939/2021 Kontrate dhurimi lrp nr. 5364/2021; ref nr. 1521/2021; dt. 08.09.2021	01.10.2021



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY


KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : KAÇANIK

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Kaçanik i vjetër

2427/2022

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-70917086-01123-6	Parcelë / Parcela / Parcel	1001



Shkalla/Razmera/Scale: 1:313

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 25.01.2022

Koha/ Vreme/ Time: 09:52:13

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:

Aprovoj/Usvojio/Approved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Signature:





REPUBLIKA E KOSOVËS

0104 - Kërkesë e përgjithshme ndaj komunës

Drejtoria / Njesia

D. V.K.H.H

Data

25.01.2022
(dita / muaji / viti)

Logo e Komunës

1 Informatat personale të parashtruesit të kërkesës:

Emri dhe mbiemri

KESHILCI I BASHKËSISË ISLAMIJE

Lloji dhe numri i dokumentit identifikues

Data e lindjes

(dita / muaji / viti)

Adresa e vendbanimit

(numri i shtëpisë/banesës, rruga, fshati/qyteti, kodë postar)

Numri i tel. fiks

Numri i tel. mobil

E-mail adresa

049-366-566

Mos shkruani në këtë pjesë

Pranuar nga:

Numri i protokollit:

06-350/01-2433/22

Vendimi: po jo

Nga:

Data:

2 Kërkesë për (shëno llojin e kërkesës):

1. Për:

2. Lënda:

NDËRRIM DESTINIMI

3 Shpjegoni më poshtë kërkesën tuaj në detaje:

KËRKESË PËR NDËRRIM TË DESTINIMIT NË PARCELESH ME NR. 01123-6, ZGJIA KADASTRALE KAGANIK I VJETËR.

NDËRRIM TË DESTINIMIT NGA TOKA BUDGËSORE NË TOKË INDIKTIMORË PËR INDIKTIMIN E XHAMISË.

4 Dokumentet shtesë (nëse ka), shëno më poshtë:

- KOPJA E PLANIT DHE FLETA POSEDORESE

5 Dëshmia e aplikuesit për vërtetësi:

Unë HAMIR HAMITI
(Emri i plotë i aplikuesit)


vërtetoj se informatat e lartshënuara janë të vërteta.

(Nënshkrimi)

*** Ju lutemi të kërkonit nga zyrtari/ja fletëdëshminë për dorëzimin e kësaj kërkesë dhe dokumenteve të bashkangjitura ***



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo
Data: 28.01.2022



Komuna Kaçanik
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

Nr. vrojtimit të lëndës: 06-350/01-2433/22

Në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, në bazë të Planit Zhvillimor Komunal, pas kërkesës së KBI Kaçanik për Pëlqim, Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit jep këtë:

PËLQIM

Për ndërtimin e Xhamisë në ngastrën kadastrale 01123-6 , zona kadastrale Kaçanik i Vjetër.

Ky Pëlqim, vlen për fillimin e procedurave për rregullimin e dokumentacionit për ndërtimin e objektit.

Arsyetim: Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, ka dhënë këtë Pëlqim, duke u bazuar në të dhënat e Planit Zhvillimor Komunal dhe të dhënat e çëftikatës së pronës, të evidentuar me nr. 01123-6, me kulturë arë e klasës 6, me pronar Këshilli i Bashkësisë Islame Kaçanik.

Këshilla Juridike: Kundër këtij Pëlqimi, palët e pakënaqura kanë të drejtë ankese 15 ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Zyrtar për Ndërtimtar,

Rufat Muça

Drejtori i DUKMM,

Qamil Stagova

